



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.155/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Afiejete Sada-Gillogjani dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore, Florije Krasniqi duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Deçan, për shkak të vendosjes së posterëve në afërsi të Qendrës së Mjekësisë Familjare, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** si të pabazuar ankesa ZL.Anr. 155/2017, e parashtruar nga BIRN me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që t’iu shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Deçan për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

### A r s y e t i m

Me datën 09.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se posteri i kandidatit për kryetar të Komunës së Deçanit, nga radhët subjektit politik AAK, është vendosur në afërsi të objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare, në Deçan. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1, pika b), të LZP-së Ligji Nr. 03/L-073, Rregulla 13/2013 nga ana e subjektit politik AAK, duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkelur këtë nen në momentin që kanë vendosur poster në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur një CD lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 10.10.2017, subjekti politik AAK, thekson se ankesa e BIRN është e pa bazuar për faktin se nga video-incizimi të cilin pala ankuuese e ka bashkangjitur, “Billbordi” në të cilin është vendosur fotoja e kandidatit për kryetar të Komunës së Deçanit, është i vendosur në atë lokacion i cili është i dedikuar ekskluzivisht për reklamime të tilla, gjatë fushatës, kryesisht reklamime politike, dhe jashtë fushatës më tepër komerciale. Për më tepër subjekti politik AAK kërkon që ankesa në fjalë të hidhet poshtë si e pa bazuar. Ndërsa subjekti politik AAK, në përgjigjen në ankesë të datës 10.10.2017, thekson se vendosja e billbordit në afërsi të QKMF-së është në pajtueshmëri të plotë me kodin zgjedhor, hapësira reklamuese nuk është në oborrin e QKMF-së, në pronësi, në rrethojat, përpara hyrjes ose në kënd ku mund të shihet prej QKMF-së

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesat janë të pa pabazuara**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politike AAK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika b) të LZP-së, për arsye e posterat e vendosur në afërsi të QKMF-së, gjatë fushatës është e lejuar, ndërsa ky veprim është i ndaluar dhe duhet të largohen në distancë prej 100 metra, 24 orë para hapjes së Qendrës së Votimit në ditën e votimit. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në ankesë në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL. Anr.155/2017 më datën 12.10.2017.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.